



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 256 prot.

Fushë-Arrëz, më 30. 01. 2025

VENDIM

Nr. 5, datë 27. 01. 2025

PËR

**"PËR MIRATIMIN E LISTËS TË FAMILJEVE QË DO TË PËRFITOJNË
PËRMIRËSIMIN E BANESAVE EKZISTUESE NË BASHKINË FUSHË-ARRËZ
PËR VITIN 2025"**

Bazuar në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, ligjin nr.22/2018, "Per Strehimin Social", VKM :362 datë 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.459 datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Nr.11 datë 07.01.2025 për "Ngritjen e Komisionit të Strehimit për vitin 2025", me propozim të Kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz dhe Komisionit të Strehimit për vitin 2025, **Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës 27.01.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura,

VENDOSI:

1. Të miratojë Listën emërore të familjeve që do të përfitojnë përmirësim të banesave ekzistuese për vitin 2025.
2. Të miratojë shumën me vlerë totale prej 8,847,000 lekë për përmirësim të banesave ekzistuese për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2025, për tu financuar në masën 80% nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit në vlerën prej 7,077,600 lekë, dhe në masën 20% nga Bashkia Fushë-Arrëz në vlerën 1,769,400 lekë.

Bashkëngjitur tabela me listën emërore dhe shumat e përkatëse.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Diasporës, Migracionit, Çështjeve Sociale, dhe Projekteve, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Financës dhe Tatimeve.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

12 vota pro


0 vota kundër

0 vota abstenim

Zbardhur, më 30. 01. 2025.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ



KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

